

## **Mbarshtimi i gjedhit- Përgatitja optimale e lopëve të qumështit për laktacionin e ri.**

*Përmbledhja e një referati gjatë një seminari për mbarështimin e gjedhit, mbajtur në Vjenë nga Bianca Duro, Drejtore e Përgjithshme e AUSTRIA PRÄMIX, përfaqësuese e Fa. SCHAUMANN për Shqipërinë dhe Kosovën.*



### **Të ushqyerit në fazën tranzitore**

Ndryshimi i metabolizmit të lopëve para laktacionit, si dhe nevojat e tyre specifike për lëndë ushqyese në këtë fazë, kërkojnë një trajtim të veçantë të tyre.

Sistemet e të ushqyerit për lopët me rendimente të larta kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore. Të ushqyerit në fazën përgatitore ka një ndikim të madh në shëndetin e lopëve dhe rendimentin e qumështit. Të ushqyerit korrekt, sipas kërkesave të organizmit në periudhën e tharjes, duhet të konceptohet në dy faza:

Gjatë periudhës së parë të tharjes, në 8-4 javë para pjelljes, racionet ushqimore duhen përpiluar për të mbuluar nevojat për mirëmbajtje, si dhe një rendiment prej 6 kg qumësht.

Kjo i korrespondon një konsumi prej 11-12 kg lëndë të thatë, si dhe një nivel energjie 5 deri 5,4 NEL/kg lëndë e thatë, duke ruajtur nivelin jo ekstremisht të lartë të proteinave bruto (12.5% - 14 %), nga ana tjetër, duke garantuar furnizim optimal me vitamina dhe lëndë minerale.

Konceptimi i të ushqyerit të lopëve, duke filluar nga dita e 21-të para pjelljes, duhet orientohet në përgatitjen e sistemit të tretjes së lopës dhe specifikisht në funksionalitetin bakterial të rumenit, villet e rumenit dhe metabolizmin optimal të organizmit.

Duhet të mbahet parasysh që në periudhën e tharjes, në ditët e fundit përpara pjelljes, vihet re një rënie tipike e konsumit të lëndës së thatë. Kjo shkakton mobilizimin e yndyrës trupore të lopës, fakt që demonstron nëpërmjet prezencës së lartë të acideve yndyrore të paesterifikuara në plazmën e gjakut, menjëherë pas javës së parë të pjelljes.

Ky fakt shoqërohet me përqëndrim të lartë të yndyrave në mëlçi dhe dëshmon se gabimet në të ushqyerin e lopëve në 6 javët e fundit para pjelljes, bëhen shkak për anomalitë metabolizmit, si për shembull shfaqje e ketozës si dhe probleme të tjera të metabolizmit, e deri në probleme të vazhdueshme të pjellorisë dhe rendimentet e ulta në prodhimin e qumështit.

**Faza kritike:** mungesa e lëndëve ushqyese gjatë kësaj faze kritike, bëhet shkak për mos-funksionim optimal të sistemit imunitar tek lopët.

**Si vlen rekomandimi i rëndësishëm për këtë fazë:** të ushqyerit me racione ushqimore, me përqindje sa më të lartë të lëndës së thatë.

Prandaj përdorimi i silazheve më cilësore të misrit dhe atij pranveror është kusht për të ushqyerin optimal të lopëve në këtë fazë.

Një start i suksesshëm në fazën e laktacionit është i mundur vetëm nëse:

Para pjelljes, lopët nuk duhet të shtojnë, por as nuk duhet të humbasin në peshë. Lopët e dhjamosura, konsumojnë shumë më pak ushqim, sidomos në fazën e parë të laktacionit dhe vuajnë veçanërisht nga humbje e menjëherëshme e yndyrave trupore, gjë që çon në mbingarkesë të funksionit të mëlçisë.

Në këtë fazë duhet të aplikohet të ushqyerit me racione të balancuara me proteinë, me ushqime voluminoze të cilësisë së lartë, me përqindje të lartë proteinike (maksimumi 17% proteinë bruto), të cilat nuk devijojnë më shumë se 10% nga racionet e lopëve në fazën e laktacionit.

Të ushqyerit me koncentrat special për këtë periudhë, çon në një prodhim më të lartë të acidit propionik në rumen, i cili gjithashtu stimulon zhvillimin e villeve dhe ndikon në absorbim të përmirësuar të acideve yndyrore të paqëndrueshëm.

Përveç kësaj, me vlerë të veçantë është përdorimi i proteinave të cilësisë së lartë. Kjo ndikon uljen e ngarkesës me kalium dhe amoniakut.

Funksionimi i rumenit të lopëve në periudhën tranzitore, mund të mbështetet edhe nëpërmjet aplikimit në një sasi të konsiderueshme të ushqimeve me strukturë.

Një rol të rëndësishëm në mirëqënien e lopëve në laktacion, është të ushqyerit me ushqime të freskëta, e shoqëruar me komfort optimal të tyre në stallë.

**Ndërrhyrja e shpejtë:** Në rastet e anomalive të metabolizmit, ndërrhyrja e shpejtë është një kusht i domosdoshëm për një menaxhim të suksesshëm të tufës.

Mbikëqyrje e vazhdueshme e lopëve në këtë periudhë tranzitore, brenda javës së parë e deri në 10 ditë pas pjelljes, do të thotë që fermeri të jetë i përgatitur për reagime të shpejta dhe masa konkrete përmirësuese.

### **Përmbledhje:**

Objektivi i të ushqyerit në fazën tranzitore është që lopët të përgatiten për fazën pasardhëse, me racione për rendimente të larta, si dhe përgatitjen e tyre për të mos u përballur me problemet e para dhe pas pjelljes të diktuar nga të ushqyerit problematik.

Pikënisja është gjithmonë dita kur lopa kalon në tharje. Kondicioni i kafshëve në këtë moment është vendimtar për laktacionin e ardhshëm. Lopët të cilat në këtë periudhë janë shumë të dobëta apo shumë të dhjamosura, si dhe lopët me dy viça kërkojnë një vëmendje më të veçantë.

Në gjysmën e parë të periudhës së tharjes duhet të merren në konsideratë kërkesat e organizmit për lëndë ushqyese për mirëmbajtje si dhe nevojat e periudhës së barsmërisë. Në 14-21 ditët e fundit para datës së pritshme të pjelljes, fillon të ushqyerit përgatitor për periudhën e laktacionit. Përparësi në këtë fazë ka aplikimi i racioneve me komponentë të njëjtë si në racionet e laktacionit.

Qëllimi primar i parapërgatitjes për laktacion është që të arrihet një asimilim maksimal i lëndëve ushqyese në rumen.

Një para përgatitje intensive e të ushqyerit me koncentrimin e duhur të energjisë dhe karbohidrateve, mund të "stërvisë" paretet e rumenit dhe në këtë mënyrë mundësohet asimilim eficient i lëndëve ushqyese.

Praktika ka vertetur që kjo strategji e të ushqyerit mund të arrihet edhe me aplikimin e përqindjes së lartë të silazhit të misrit në racion.

Meqë normalisht silazhi i misrit konsumohet me kënaqësi nga lopët, me anë të kësaj mënyre, mund të përmirësohet shumë mirë sasia e ushqimit të konsumuar.